



Datë: 01.09.2025
Numër Protokolli: 5943/2025

A.nr.758/2025

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës – Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi, kryetare, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Eshref Shabani, anëtarë, me Kaltrina Avdullahi Prenaj, në cilësinë e procesmbajtëses, në procedurë sipas ankesës më A.nr.758/2025, të datës 29.04.2025, të parashtruar nga ankuesja, V.H, kundër organit të punësimit: Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në çështjen juridike “kontestim konkursi”, duke vepruar në pajtim me Nenin 16, paragrafin 3, dhe Nenin 18, paragrafin 1, nën paragrafin 1.3 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 01.09.2025 mori këtë:

V E N D I M

I. Aprovohet si e bazuar ankesa me numër A.nr.758/2025, e datës 29.04.2025, e parashtruar nga ankuesja V.H. Anulohet në tërësi procedura e pranimit më numër reference me numër reference RN00016448, për pozitën Zyrtar i Lartë për Diagnostikimin e Patogjenëve në Ushqime, Instituti Bujqësor i Kosovës, Pejë, i shpallur me datë 07.03.2025, nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

II. Obligohet Udhëheqësi/ja i/e Njesisë së Personelit në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmerr të gjitha veprimet administrative për zbatimin e këtij vendimi siç përcaktohen në pikën I të dispozitivit.

III. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Kandidatja për pranim në shërbim civil V.H (në tekstin e mëtejshëm referuar: Ankuesja), më datë 29.04.2025, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër procedurës së rekrutimit me numër reference RN00016448, për pozitën Zyrtar i Lartë për Diagnostikimin e Patogjenëve në Ushqime, Instituti Bujqësor i Kosovës Pejë, Ministria e Bujqësisë Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (në tekstin e mëtejme referuar: Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 08.05.2025, ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, ndërsa, kjo e fundit, më datë 21.05.2025, ka përcjellë përgjigjen në ankesë së bashku me shkresat materiale referuar çështjes në procedurë.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave (në tekstin e mëtejme referuar: Kolegji i Këshillit) pas konstatimit se ankesa është e pranueshme në kuptim të dispozitave të nenit 129 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi për shqyrtimin e të njëjtës, kështu që për vendosje meritorë administroi këto prova: Ankesën me numër protokolli 2815/2025 të datës 29.04.2025 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Kopjen e letërnjoftimit; Formularin e parashtrimit të ankesës së datës 29.04.2025; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 08.05.2025; Përgjigjen në ankesë të datës 21.05.2025 së bashku me dokumentet e dorëzuara nga organi i punës; Konkursin me numër reference RN00016448; Listën e aplikantëve; njoftimin e datës 05.03.2025; Vendimin e datës 19.03.2025; Vendimin e datës 03.11.2023; Vendimin e datës 13.11.2024; Kërkesën e datës 13.11.2024; Akt emërimit të datës 05.07.2013; Akt emërimit të datës 12.11.2018; Akt emërimit të datës 01.01.2014; Njoftimin për testin me shkrim; Testin me shkrim për ankuesen V.H; Testin me shkrim për kandidatin fitues B.K; Listën e aplikantëve; Njoftimin për intervistën me gojë të datës 28.03.2025; Formularët e vlerësimit të intervistës me gojë; Aplikacionin me datë aplikimi 20.02.2025 për kandidaten V.H; Aplikacionin me datë aplikimi 21.02.2025 të kandidatës B.K së bashku me dokumentet e bashkangjitura; Vendimin me numër protokolli 4049/2025 të Kryetarit të Këshillit; Kërkesën e datës 16.06.2025 drejtuar Agjencisë së Akreditimit të Kosovës; Rikujtimin e kërkesës së datës 16.06.2025 (të përcjellë më 17.06.2025); Përgjigjen e datës 19.06.2025 nga Agjencia e Akreditimit të Kosovës; Kërkesën e datës 19.06.2025; Rikujtimin e kërkesës së datës 19.06.2025 (të përcjellë më 20.06.2025)., emal i datës 29.08.2025 nga KPMSH për DMZ-në lidhur më njoftimin për aprovim të përshkrimit të detyrave të punesa për pozitën Zyrtar i Lartë për Diagnostikimin e Patogjeneve në Ushqime, dhe emaili konfirmues i Drejtorit të DMZ-së i datës 29.08.2025.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në vlerësimin e hollësishëm të çdo prove veç e veç dhe të gjitha provave të marra së bashku, si dhe bazuar në rezultatin tërësor të shqyrtimit administrativ, ka gjetur se ankesa është e bazuar, sepse:

Nga administrimi i shkresave të lëndës rezulton se Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, më datë 23.01.2025, ka shpallë konkursin publik me numër reference RN00016448, për Grupin e shkencave natyrore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Diagnostikimin e Patogjeneve në Ushqime, në Institutin Bujqësor të Kosovës në Pejë, më klasë të pozitës Profesional 1, një (1) vend i lirë pune, i hapur për aplikim nga 24.01.2025 deri më 22.02.2025.

Rrjedhimisht, nga shkresat e lëndës rezulton se në këtë konkurs kanë aplikuar edhe ankuesja e cila ka kaluar fazën e verifikimit paraprak duke i plotësuar kushtet e konkursit, dhe se e njëjta i është nënshtruar vlerësimit profesional, gjegjësisht në testin me shkrim është vlerësuar më 55.6 pikë, ndërsa në intervistën me gojë më 27.2 pikë, gjithsej 82.8 pikë, mirëpo sipas renditjes përfundimtare të rezultateve të vlerësimit ankuesja është renditur si kandidatja e dytë më shumë pikë të arritura, rrjedhimisht, si kandidat më shumë pikë rrjedhë te jetë B.K me gjithsej 91.2 pikë(64.8 pikë në testin me shkrim dhe 26.4 pikë në intervistën me gojë), ashtu që edhe i njëjti është shpallura edhe kandidat fitues sipas Njoftimit me numër protokolli Nr.1281, të datës 03.04.2025 të Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore në MBPZHR-së.

Pas publikimit të Njoftimit me numër protokoli Nr.1281, të datës 03.04.2025, ankuesja ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar ligjshmërinë e kësaj procedure. Shton se kandidati i sukseshëm është përzgjedhur në bazë të preferencave politike, e gjithashtu i njejtë sipas ankuses testin me shkrim e ka përfunduar për 10 minuta, shton se eka pas parregullsi gjate organizimit dhe mbajtjes së testit me shkrim duke supozuar se ka pasur ndërhyrje edhe në sistem. Kërkon nga Këshilli që të aprovoj ankesën si të bazuar dhe të anuloh procesin e rekrutimit në tërësi.

Kolegji i Këshilli mbështetur në mandatin kushtetues dhe ligjor lidhur me sigurimin e respektimit të rregullave dhe parimeve që rregullojnë shërbimin civil, e ndërlidhur me nenin 86 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ku përcaktohet se: “Organi publik përcakton, në mënyrë të pavarur, llojin dhe shtrirjen e shqyrtimit administrativ, si dhe vlerëson nëse një fakt apo rrethanë është e nevojshme për zgjidhjen e çështjes”, lidhur me këtë çështje ankimore ka analizuar aktin e shpalljes së konkursit publik me numër reference RN00016448, për Grupin e Shkencave Natyrore, respektivisht për pozitën e punës Zyrtar i Lartë për Diagnostifikimin e Patogjeneve në Ushqime, dhe si rrjedhojë nga analizimi i të njëjtit ka gjetur se kërkesa të përgjithshme formale par këtë pozitë janë vendosur: Arsimimi i kërkuar: Diplomë e arsimit të lartë e nivelit të parë (Bachelor). • Biologji, Zoologji, Agrikulturë, Hortikulturë, Pylltari, Gjeografi, Fizikë, Kimi, Matematikë, Ekologji, Agromomi, Veterinari, Mjedis. Përvoja e punës e kërkuar: Së paku dy (2) vite përvojë pune profesionale në fushën për të cilën zhvillohet procedura për plotësimin e pozitës së lirë të punës...

Rrjedhimisht, në kuptim të kërkesave të përgjithshme formale dhe klasifikimit të pozitës së kontestuar, Kolegji ka analizuar Rregulloren (ZKM) Nr.07/2023 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Agjencinë për Zhvillimin e Bujqësisë, në fuqi në kohën e shpalljes së konkursit me nr.Ref:RN00016448 dhe si rrjedhojë pozita Zyrtar i Lartë për diagnostikim e patogjeneve të ushqimit, nuk parashihet si pozita me këtë rregullore, dhe po ashtu kjo pozitë nuk parashihet as më Katalogun e Vendeve të Punës në Shërbim Civil.

Gjegjeshit, Kolegji nga shqyrtimi i provave materiale ka gjetur se më datë 23.01.2025, pra në ditën e shpalljes së konkursit në fjalë, MBZHR ka miratuar përshkrimin detyrave të punës për pozitën Zyrtar i Lartë për Diagnostikimin e Patogjeneve në Ushqime, duke mos ndjekur procedurat ligjore sipas Rregullores (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil dhe sipas këtij përshkrim pozita në fjalë nuk është grupuar në kategori dhe klasë ashtu siç kërkohet me këtë rregullore.

Në fakt, bazuar në përshkrimin e detyrave të punës të datës 23.01.2025, si kërkesa formale janë përcaktuar Arsimi: Fakulteti i Biologjisë, Fakulteti i Bioteknologjisë Ushqimore dhe Teknologjia Ushqimore, niveli i parë Bachelor; Përvoja e Punës: dy vite përvojë pune. Pra, kërkesat formale sipas përshkrimit të detyrave të punës nuk janë në pajtim me Rregulloren (QRK) Nr.06/2024 për Klasifikimin e Vendeve të Punës në Shërbimin Civil, pra, në rastin konkret përshkrimi përcakton kriteret tjera nga ato të caktuara me konkurs.

Për më tepër, Kolegji ka analizuar edhe përshkrimin e detyrave të punës sipas klauzolën 1 të konkursit me nr.ref: RN00016448, ku përcaktohet se: 1. Përgatitja e procedurave operative standarde – SOP dhe validimin e metodave laboratorike konform standardit ndërkombëtar ISO 17025:2017 dhe AOAC për diagnostikimin e patogjenëve në ushqime me origjinë bimë. 2. Bën monitorimin e parametrave mjedisore dhe mirëmbajtjen e pajisjeve në Laboratorin e Kontrollit të Cilësisë Ushqimore në pjesën e Mikrobiologjisë Ushqimore.

3. Bën përgatitjen e terreneve ushqyese, kultivimin dhe inkubimin e patogjenëve ushqimor konform procedurave operative të Standardeve Ndërkombëtar ISO 17025:2017 dhe AOAC, si dhe diagnostikimin mikroskopik të patogjenëve të zhvilluar në terrenet ushqyese. 4. Bën hartimin dhe lëshimin e raporteve laboratorike dhe interpretimin e rezultateve lidhur me identifikimin e patogjenëve ushqimor. 5. Në bashkëveprim me stafin udhëheqës për sistemin e menaxhimit të cilësisë – SMC, siguron akreditimin kombëtar dhe ndërkombëtar të parametrave përkatës analitik, siguron pjesëmarrjen në testet krahasimore ndër laboratorike dhe Testet e Zotësisë. 6. Mban koordinim të ngushtë me divizionet e Institutit Bujqësor të Kosovës dhe partneret e tjerë të mundshëm. 7. Sipas nevojës kryen edhe punë tjera nga fushëveprimtaria e punës së vet brenda Laboratorit të kontrollit të cilësisë së ushqimit dhe kryen punë tjera bazuar në nevoja institucionale. 7. Kjo pozitë i raporton dhe mbikëqyret drejtpërdrejt nga Drejtori i Institutit të Bujqësisë të Kosovës.

Andaj, referuar të gjeturave dhe konstatimeve si më sipër, rrjedhë së akti i shpalljes së konkursit me nr.ref: RN00016448, është përfshirë më shkelje ligjore, të cilat si të tilla procedurën e kontestuar e bëjnë të paligjshme në kuptim të nenit 52, paragrafi 1, nën paragrafi 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative. Rrjedhimisht, duke qenë së akti e shpalljes së konkursit kontestues është përfshirë më shkelje esenciale materiale, atëherë, çdo veprim tjetër procedural i ndërmarrë në këtë procedura është juridikisht i pavlefshëm dhe nuk prodhon efekte juridike, kështu që, mbi këtë bazë të konstatimit, Kolegji nuk ka trajtuar ligjshmërinë e fazave tjera procedurale, të pasuara pas përmbylljes së konkursit përkatës dhe të kontestuar më ankesë.

Thëne si më lartë, Kolegji në mbështetje të nenit 18, paragrafi 1, nën paragrafi 1.2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, e me qëllim të kthimit të ligjshmërisë, vendosi për aprovimin e ankesës si të bazuar, duke anuluar në tërësi procedurat e pranimit të shpallura sipas konkursit me numër reference RN00016448.

Këshillë juridike: Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij Vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.758/2025

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Procesmbajtese

Ardita Haxhnikaj Demi

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses, V.H;
- Organit të punësimit: Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në MBPZHR; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së